

VENDIM
Nr.630, datë 18.9.2003

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE E SHITESAVE NË PROCEDURAT E
PRIVATIZIMIT DHE TË TERMAVE TË KONTRATËS SË SHITJES SË AKSIONEVE TË
BANKËS SË KURSIMEVE SHA, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.452, DATË 28.6.2001
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8563, datë 22.12.1999 "Për përcaktimin e formës dhe formulës së privatizimit të Bankës së Kursimeve sh.a.", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e disa ndryshimeve e shtesave në procedurat e privatizimit dhe të termave të kontratës së shitjes së aksioneve të Bankës së Kursimeve sh.a., sipas dokumenteve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano